



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtorati Për Inspekcione

10 Nr. \_\_\_\_\_ /2021 Dt. 9 / 12 /2021

10 Nr. \_\_\_\_\_  
Datë: 9.12.2021



Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës

Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione

Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2021

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, gjate vitit kalendarik 2021 kanë kryer kryer punët dhe detyrat e punës konform Ligjeve dhe akteve nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2021.

Gjatë këtij viti në kuadër të Drejtoratit kanë qenë të angazhuar ;Inspektori i Tregut, Inspektori Sanitarë, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë për Shërbime të veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me Kontratë për Shërbime të veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Vlen të theksohet se inspektori i ndërtimeve i angazhuar me Kontratë për shërbime të veçanta, e ka ndërprerë të njëjtën në mesin e shkurtit të këtij viti, ndërsa zëvendësimi i tij është bërë në muajin Nëntor, çka nënkupton se pothuaj se gjate ter vitit raportues Drejtorati i inspekcionit ka qenë pa Inspektor të ndërtimit edhe përkundër mjaft problemeve nga kjo fushë.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Karakteristike edhe gjatë këtij viti ka qenë ballafaqimi me zbatimin e masave Anti Covid-19 të ndërmarra nga organet kompetente dhe që dalin nga Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore si dhe kushtet higjienike dhe sanitare të objekteve dhe stabilimenteve.

Janë bërë kontrole inspektuese lidhur me ndërtimet pa leje si dhe të atyre në kundërshtim me lejet e lëshuara nga Drejtorati për Urbanizëm (për aq sa ka qenë inspektori i angazhuar).

Nga Inspektori i Veterinës si kompetencë e deleguar nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit është bërë mbikëqyrja e therjes së kafshëve dhe vulosja e mishit të therur neper thertore.

Çdo javë në ditën e tregut është bërë mbikëqyrja e tregu të gjelbër.

Janë bërë kontrole sipas kërkesës së policisë posaçërisht për mallrat e hasura ne transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura ne subjektet tregtare, ku vlen të theksohet se ka ekzistuar një bashkëpunim mjaft i mirë. Gjithashtu bashkëpunim i mirë me policinë e Kosovës është bërë edhe me krijimin e task forcës së përbashkët për zbatimin e masaqva Anti Covid.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimiti i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe te mbrojtjes në punë.

Jan kryer edhe shumë aktivitete nga fushe veprimtaria e Drejtoratit për Inspekcione.

Nder të tjera gjate punës se tyre inspektoret kanë kryer aktivitetet si ne vijim:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	113	42	64	22	6
I Ndertimit					
I Veterinës	46	4	18		
Sanitar	132	6	96	22	1
I bujqësisë	49	17	21		
<b>Gjithsejt</b>	<b>340</b>	<b>69</b>	<b>199</b>	<b>44</b>	<b>7</b>

Inspektorja e Ambientit deri në momentin e përpilimit të këtij Raporti nuk ka ofrua të dhëna.

Përveç të lartcekurave meqenëse edhe ky vit ishte vit Pandemie nga Drejtorati, gjegjësisht nga inspektori sanitar janë realizuar edhe:

1. Vendime për izolim .....1 288
2. Vendime për dalje nga izolimi.....924
3. Monitorim i varrimeve të  
Të personave të vdekur nga Covid... 23


  
**Halil Tolaj**